

Datë: 17.02.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbim printimi dhe fotokopjimi për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

79810000-5

VLERA E FONDIT LIMIT: 5,304,460 (pesë milion e treqind e katër mijë e katërqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

b. Formulari i ofertes sipas Shtojcës 1;

c. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: **Sipas shtojcës 9.**

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të Marrëveshjes Kuadër. Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c, neni 55 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të marrëveshjes kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4, gërma b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 55, pika 4, gërma b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar marrëveshjen kuadër, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të deklarojnë se disponojnë pajisjet e nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:

Emërtimi	Njësi	Sasi
----------	-------	------

Printer/kopje/skanim All in ONE A4 bardh/zi	copë	51
Printer/kopje/skanim All in ONE A4 color	copë	15
Printer Fotokopje Multifunkionale A4/A3	copë	3

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

- Deklarate ku të cilesohet prodhuesi i paisjeve dhe nese keto pajisje ofertuesi i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje.
- katalog/skedë teknike të prodhuesit, ku të tregohen qartë karakteristikat e pajisjeve, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmeria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara.

Shenim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor, ofertuesi i kualifikuar i pari, duhet të paraqesë (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë) për pajisjet e deklaruar.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion pajisjet për kryerjen e shërbimit për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Pajisje të kërkuara nga autoriteti kontraktor përfitues fundor i këtij shërbimi. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar shërbimin e kërkuar si dhe për të verifikuar plotësimin e specifikimeve teknike të shërbimeve, objekt prokurimi.

2.3.3 Operatorët ekonomikë duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e e shërbimit objekt prokurimi, si më poshtë:

2 (dy) inxhinierë të fushës së teknologjisë së informacionit IT, informatikës, inovacionit, elektronikës apo mekanik. Për këta punonjës të paraqitet diploma e kërkuar dhe kontrata e punës e vlefshme me operatorin ekonomik ofertues.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kjo kërkesë vjen si kusht kryesor për kapacitetin profesional të operatorëve ekonomik ofertues. Profili i kërkuar lidhet ngushtë me objektin e prokurimit dhe lë të hapur çdo fushë të teknologjisë së informacionit, elektronikës, inovacionit dhe çdo fushë tjetër të diplomimit në Shqipëri dhe ndërkombëtarisht që lidhet me objektin e prokurimit që është shërbim printimi dhe fotokopjimi. Kërkesa për 2 punonjës të vjen si kërkesë e zbatimit në terren e marrëveshjes kuadër, të cilët do të jenë në gadishmeri për çdo pyetje, paqartësi, defekt apo çdo nevojë që lind gjatë zbatimit të marrëveshjes kuadër. Prania e disa inxhinierëve lejon ndërhyrje të shpejtë, zgjidhje të defekteve dhe mbështetje teknike në terren, duke shmangur vonesat në ofrimin e shërbimit. Pas vendosjes së printerëve, nevojitet monitorim dhe mirëmbajtje. Inxhinierët e fushave të mësipërme janë të aftë të realizojnë zbulimin e defekteve, zëvendësim të komponentëve

elektronikë/mekanikë etj. Printerët që përdoren në institucione publike mund të përpunojnë dokumente konfidenciale, dhe inxhinierët e IT dhe sigurisë mund të garantojnë që pajisjet të konfigurohen në mënyrë që të respektojnë protokollet e sigurisë dhe privatësisë, duke parandaluar rrjedhje informacioni. Ky është një shërbim me shtrirje të gjerë, që kërkon punonjës të certifikuar për të garantuar cilësi, siguri dhe vazhdimësi.

2.3.4 Operatoret ekonomike duhet të duhet të paraqesin një deklaratë me anë të së cilës të deklarojnë se riparimi i pajisjes së difektuar do të realizohet sipas përcaktimeve të vendosura në specifikimet teknike.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, me qëllim që AK të krijojë siguri për që ofertuesi merr përsipër ekzekutimin e kontratës, sipas të gjitha kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike.

2.3.5 Operatoret ekonomike duhet të duhet të paraqesin një deklaratë me anë të së cilës të deklarojnë se marrin përsipër transportin e pajisjeve të kërkuara në pikën 2.3.2 në adresën e Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, me qëllim që AK të krijojë siguri për që ofertuesi merr përsipër ekzekutimin e kontratës, sipas të gjitha kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhena të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, termat e referencës dhe përllogaritja e fondit limit janë përgatitur dhe hartuar nga Autoriteti Kontraktor **Agjencia e Mbikëqyrjes Policore** për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.